

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR CENSIN E POPULLSISË DHE TË BANESAVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është krijimi i bazës ligjore të konsoliduar për kryerjen e censit të popullsisë dhe banesave, duke marrë në konsideratë standardet e reja ndërkombëtare të vendosura për censet e ardhshme të popullsisë dhe banesave, terminologjinë, procedurat dhe institucionet e përfshira. Projektligji hartohet bazuar në nenin 3, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, sipas të cilit realizimi i censit rregullohet me ligj të veçantë.

Objektivat që synohen të arrihen:

1. Prodhimi i statistikave të popullsisë dhe banesave, duke mirëpërcaktuar me ligj:
 - a) rolin e INSTAT-it, si institucioni përgjegjës për kryerjen e suksesshme të procesit;
 - b) rolin mbështetës, që luajnë institucionet e ekzekutivit dhe ato të vetëqeverisjes vendore;
 - c) rregullimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave si dhe administrimin e informacionit të mbledhur;
 - ç) detyrimet e subjekteve për të dhënë informacionin e kërkuar, nëpërmjet pyetësorëve të censit;
 - d) prodhimin e statistikave zyrtare të popullsisë dhe banesave në mënyrë profesionale, shkencore dhe të besueshme.
2. Kryerja e censit të popullsisë dhe banesave në përputhje me rekomandimet dhe standardet e reja ndërkombëtare:
 - a) duke përcaktuar terminologjitë statistikore në linjë me ato të përdorura nga Eurostat;
 - b) duke përmbushur rekomandimet e institucioneve kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me zhvillimin e censit të ardhshëm.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji rrjedh si angazhim i ndërmarrë nga qeveria shqiptare për përmirësimin e treguesve statistikorë, zyrtarë, të prodhuar nga sistemi kombëtar statistikor, dhe rritjen e imazhit të INSTAT-it e besueshmërinë e përdoruesve në statistikat zyrtare, duke e strukturuar atë në një institucion profesionalisht të pavarur (Programi i qeverisë 2013, “Statistikat”).

Ndërkohë, projektligji është i domosdoshëm për të siguruar kryerjen e aktivitetit “Censi i popullsisë dhe banesave”, parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021, miratuar me vendimin nr.20/2017, të Kuvendit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që do të sjellë, kryesisht, ky projektligj:

- a) Do të mundësojë përputhshmërinë me terminologjinë dhe përkufizimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- b) Do të mundësojë përmbushjen e rekomandimeve të Konferencës së Statisticienëve Evropianë (CES 2020) për censet e popullsisë dhe banesave;
- c) Do të mundësojë harmonizimin me ligjin nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”;
- ç) Do të mundësojë zbatimin e Strategjisë dhe Planit për Zhvillimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri;
- d) Do të përshtatë njësitë mbështetëse të nivelit vendor sipas përcaktimeve të reja nga reforma administrative dhe territoriale;
- dh) Do të forcojë rolin operacional dhe metodologjik të INSTAT-it, siç përcaktohet në ligjin nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”;
- e) Do të mbështesë strategjinë e përgatitjes së regjistrave statistikorë dhe lidhjes së tyre në të ardhmen me regjistrat administrativë.

Projektligji nuk parashikohet të sjellë problematika, ndërkohë që efektet kryesore të pritshme janë prodhimi i treguesve statistikorë, të cilët mundësojnë një panoramë të përditësuar dhe reale të situatës demografiko-sociale në vend.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar nga INSTAT-i, në bashkëpunim me një grup ekspertësh ndërkombëtarë, të siguruar me mbështetjen e qeverisë zvicerane dhe Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës, nëpërmjet projektit SALSTAT.

Projektligji paraqitet pranë Këshillit të Ministrave në mbështetje të:

- a) nenit 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- b) nenit 3, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

Projektligji është hartuar duke marrë në konsideratë standardet që parashikojnë aktet e mëposhtme, të cilat kanë të bëjnë me censet e popullsisë dhe të banesave në vendet e BE-së:

- Rregulloren (KE) nr.763/2008, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 “Për censet e popullsisë dhe banesave”;
- Rregulloren (KE) 2017/543, datë 22 mars 2017, “Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e rregullores (KE) nr.763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi censet e popullsisë dhe banesave për sa i takon specifikimeve teknike të temave dhe nënndarjeve të tyre”;
- Rregulloren (KE) 2017/712, datë 20 prill 2017, “Për përcaktimin e vitit të referencës dhe programit të të dhënave statistikore dhe metadatave për censet e popullsisë dhe banesave të parashikuara në rregulloren (KE) nr.763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”;
- Rregulloren (KE) 2017/881, datë 23 maj 2017, “Për zbatimin e Rregullores (KE) nr.763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi censet e popullsisë dhe banesave, për sa u takon modaliteteve dhe strukturave të raporteve të cilësisë dhe formatit teknik për transmetimin e të dhënave, dhe ndryshimin e rregullores (KE) nr.1151/2010”.

Projektligji synon përputhshmërinë e pjesshme me rregulloren (KE) nr.223/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 2009, e ndryshuar me rregulloren (KE) nr.2015/759, datë 29 prill 2015, me qëllim ngritjen e kornizës ligjore në përputhje me standardet e kërkuara nga BE-ja dhe Eurostat-i, në bazë të së cilës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sistemet kombëtare statistikore të vendeve anëtare.

Projektligji është hartuar me mbështetjen dhe komunikimet e vazhdueshme me përfaqësuesit e institucioneve publike, të grupeve të interesit, median,

institucionet ndërkombëtare etj., nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakëta dhe *work-shop*-eve.

Me qëllim që të krijohet një ligj me strukturë të harmonizuar, projektligji propozohet të rishikohet në tërësinë e tij, pa prekur në thelb përmbajtjen dhe vazhdimësinë e ruajtjes së standardeve ndërkombëtare për cilësinë statistikore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Meqenëse Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat, projektligji synon përputhjen, pjesërisht, me:

- Rregulloren (KE) nr.763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 “Për censet e popullsisë dhe banesave”;
- Rregulloren (KE) 2017/543, datë 22 mars 2017, “Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e rregullores (KE) nr.763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi censet e popullsisë dhe banesave për sa i takon specifikimeve teknike të temave dhe nënndarjeve të tyre”.

Përputhshmëria me aktet e lartpërmendura ka të bëjë me terminologjinë dhe përkufizimet statistikore.

Aktet e mëposhtme do të përafrohen më tej me miratimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, sipas autorizimit që jep projektligji, të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e pyetësorit, “*core topics*” dhe “*non-core topics*”, datën e censit dhe periudhën e mbledhjes së të dhënave:

- Rregullorja (KE) 2017/712, datë 20 prill 2017, “Për përcaktimin e vitit të referencës dhe programit të të dhënave statistikore dhe metadatave për censet e popullsisë dhe banesave të parashikuara në rregulloren (KE) nr. 763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”;
- Rregullorja (KE) 2017/881, datë 23 maj 2017, “Për zbatimin e rregullores (KE) nr.763/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi censet e popullsisë dhe banesave, për sa i takon modaliteteve dhe strukturave të raporteve të cilësisë dhe formatit teknik për transmetimin e të dhënave, dhe ndryshimin e rregullores (KE) nr.1151/2010”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 përcakton objektin e ligjit, i cili ka të bëjë me censin e popullsisë dhe të banesave.

Neni 2 përcakton qëllimin e censit, i cili ka të bëjë, kryesisht, me ofrimin e të dhënave demografiko-sociale për politikëbërje, kërkime shkencore, analiza etj., ndërkohë që pasqyron edhe kategorinë e të dhënave që duhet të prodhohen.

Neni 3 përmban terminologjinë statistikore, të rishikuar sipas rregulloreve të BE-së për censet e popullsisë dhe banesave. Gjithashtu, ai përmban më tepër përkufizime, në mënyrë që të shmangen paqartësitë dhe keqkuptimet.

Neni 4 i jep një interpretim të veçantë pyetësorit të censit, në mënyrë që të qartësohet përmbajtja dhe të përcaktohen kategoritë e pyetjeve që janë të detyrueshme për t'u përgjigjur dhe atyre që kanë deklaram të lirë.

Neni 5 përcakton konceptin për detyrimin ligjor të individëve për t'u përgjigjur, të drejtën që kanë për t'u njohur me këtë proces si dhe garantimin për konfidencialitetin e të dhënave që japin. Projektligji përcakton se të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët në momentin e censit ndodhen në territorin e Shqipërisë, janë të detyruar të japin në mënyrë të plotë, të saktë e të besueshme informacionin e përcaktuar si të detyrueshëm në pyetësorët e censit. Ndërkohë, nga ky detyrim përjashtohet personeli diplomatik, i akredituar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6, i projektligjit, përcakton njësitë organizative përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe mbështetjen e veprimtarisë së censit, ku përfshihen INSTAT-i, Komisioni Qendror i Censit dhe zyrat e censit në nivel bashkie. Për shkak të ndarjes së re administrative, për të shmangur veprimtaritë burokratike dhe për t'i dhënë më tepër prioritet operativitetit, projektligji nuk propozon ngritjen e komisioneve mbështetëse në nivel qarku dhe komune.

Neni 7 parashikon vendosjen e ditës së censit dhe të periudhës së mbledhjes së të dhënave në planin vjetor, për zbatimin e programit 5-vjeçar të statistikave zyrtare, i cili miratohet nga Kuvendi. Kjo mënyrë do të përcaktojë përfundimisht dhe ligjërisht datën e fillimit të periudhës së mbledhjes të të dhënave në terren si dhe momentin e censit, për të cilin do të referohen të dhënat.

Me qëllim që të sigurohet parimi i konfidencialitetit statistikor dhe destinacioni i të dhënave të mbledhura për censin, neni 8 përcakton kategoritë e të dhënave që do të mbledhen vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe nuk do të përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre statistikore.

Mbrojtja e konfidencialitetit statistikor është një nga parimet kryesore të statistikave zyrtare, i parashikuar në nenin 4 të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, trajtimi i të cilit rregullohet në nenin 31, të këtij ligji.

Neni 9, i projektligjit, përcakton në mënyrë më të hollësishme detyrimin për të respektuar konfidencialitetin e informacionit të mbledhur, në përputhje me parashikimet e ligjit të statistikave zyrtare si dhe të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar. Sigurimi ligjor i konfidencialitetit statistikor do të mundësojë dhënien e informacionit në mënyrë të saktë e objektive dhe, për rrjedhojë, prodhimin e statistikave zyrtare të besueshme.

Për të garantuar konfidencialitetin, projektligji ngarkon INSTAT-in të marrë masat e duhura teknike dhe organizative për trajtimin e të dhënave nga momenti i mbledhjes deri në arkivimin e tyre.

Neni 10, i projektligjit, përcakton që rezultatet e censit duhet të trajtohen si pasuri e shoqërisë shqiptare dhe duhet të aksesohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë përdoruesit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij neni INSTAT-i ngarkohet të publikojë të dhënat, duke shmangur çdo mundësi identifikimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, si dhe të japë të drejtën e hyrjes në të dhëna në nivel mikro vetëm për qëllime kërkimore shkencore.

Kreu II, i projektligjit, i dedikohet strukturave organizative që do të përfshihen në planifikimin, zhvillimin dhe mbështetjen e censit. Si organi kryesor për të mbikëqyrur përgatitjen dhe zbatimin e censit ngarkohet Komisioni Qendror i Censit (Neni 11). Komisioni do të ketë, kryesisht, përgjegjësinë të mbështesë INSTAT-in në kryerjen e censit, duke bashkërenduar punën ndërmjet ministrive dhe institucioneve që përfaqësohen në komision për të mundësuar mbarëvajtjen e punës gjatë mbledhjes të të dhënave në terren.

Neni 12 përcakton përgjegjësitë konkrete që do të ketë Komisioni Qendror i Censit, në mënyrë që të përmbushë misionin mbështetës të tij.

Neni 13 përcakton mënyrën e funksionimit të Komisionit Qendror të Censit dhe mbulimin e detyrave të sekretariatit të tij.

Neni 14, i projektligjit, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e INSTAT-it si institucioni kryesor udhëheqës i projektit. INSTAT-i do të ngarkohet me ligj, kryesisht, për hartimin e programit të punës (i cili shqyrtohet më tej nga Komisioni Qendror i Censit), përcaktimin e metodologjisë dhe përgatitjen e materialeve udhëzuese, manualeve etj. Gjithashtu, ai ngarkohet të raportojë periodikisht pranë Komisionit Qendror të Censit mbi ecurinë e projektit.

INSTAT-i do të ngarkohet të mbulojë edhe menaxhimin e burimeve financiare e njerëzore të alokuara për ushtrimin e aktivitetit.

Nga neni 15 deri në nenin 18 rregullohen ngritja e zyrave të censit në nivel bashkie, mënyra e funksionimit të tyre dhe përgjegjësitë. Qëllimi i ngritjes së tyre është për të mbështetur mbarëvajtjen e punës së censit në zonën që ata mbulojnë, duke vënë në dispozicion ambientet dhe burimet që disponojnë.

Kreu III, i projektligjit, i dedikohet anës përgatitore dhe procedurale të censit, duke përcaktuar kryerjen e fushatave informuese, kategoritë e njerëzve që do të angazhohen në proceset e mbledhjes dhe përpunimit.

Në nenin 19 parashikohet organizimi i një fushate të gjerë informuese për të ndërgjegjësuar shtetasit për rëndësinë e procesit, kategorinë e të dhënave që do të mbledhen, mënyrën e dhënies së informacionit si dhe detyrimet ligjore që kanë për dhënien e informacionit. Projektligji ngarkon INSTAT-in të udhëheqë këtë proces, ndërkohë që fillimi i tij duhet të jetë jo më vonë se 8 javë nga data e censit.

Neni 20, i projektligjit, përcakton personelin që do të angazhohet në cens. Sipas këtij neni, në personelin e censit do të përfshihen stafi i terrenit (anketues, kontrollorë, mbikëqyrës, specialistë IT, specialistë GIS) si dhe stafi tjetër, i cili do të merret me administrimin e procesit, sigurimin e kapaciteteve profesionale, përpunimin dhe publikimin e të dhënave (trajnerët, operatorët, personeli drejtues, statisticienë etj.). Për zgjedhjen e personave të duhur, projektligji ngarkon INSTAT-in të përcaktojë kriteret dhe të ngrejë komisione *ad-hoc* për shqyrtimin e kandidaturave.

Një çështje e rëndësishme që parashikon ligji është ajo e ndalimit të ushtrimit të çfarëdolloj veprimtarie statistikore gjatë periudhës, e cila fillon jo më vonë se 6 javë përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes të të dhënave në terren (neni 21). Arsyeja e vendosjes së kësaj dispozite është për të shmangur ngarkesën e përgjigjeve të individëve dhe konfuzionet në të dhënat e mbledhura. Sidoqoftë, për raste përjashtimore dhe kur gjykohet e arsyeshme, kompetencën për kryerjen e aktiviteteve të ngjashme njëkohësisht me atë të censit e ka Komisioni Qendror i Regjistrimit.

Me qëllim që të sigurohet respektimi i detyrimeve ligjore, në kreun IV parashikohet marrja e masave administrative ndaj personave që refuzojnë dhënien e informacionit, japin informacion të rremë, shkelin konfidencialitetin statistikor dhe kryejnë, pa autorizimin e Komisionit Qendror të Censit, aktivitete të mbledhjes së të dhënave gjatë periudhës së censit. Risi e projektligjit është

përrjashtimi nga penalizimi për individët në rastet e pyetjeve që janë me vullnet të lirë të përgjigjes.

Për të vlerësuar konstatimin dhe nivelin e shkeljes, projektligji ngarkon INSTAT-in, nëpërmjet nenit 23, të tij. Në nenin 24 parashikohen edhe rastet e ankimit ndaj vendimeve të INSTAT-it për kundërvajtjet pranë Komisionit Qendror të Censit dhe Gjykatës Administrative.

Kreu V është i fundit i projektligjit dhe ka të bëjë me përcaktimin e dispozitave kalimtare, duke vendosur shfuqizimin e ligjit ekzistues nr.8669, datë 26.10.2000, “Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, të ndryshuar, për shkak të rishikimit tërësor të tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji ngarkon INSTAT-in, ministritë e linjës, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe organet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e projektligjit janë angazhuar stafet e INSTAT-it, të ministrive të linjës, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Departamentit të Administratës Publike, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Komitetit për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si dhe përfaqësues të grupeve të interesit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Sipas projektbuxhetit paraprak të përlogaritur, duke u bazuar në aktivitetet në tërësi që nevojiten për kryerjen e censit si dhe duke marrë në konsideratë zërat që kanë ofruar donatorët e ndryshëm, nga buxheti i shtetit nevojitet një vlerë prej 8 300 000 eurosh = **1 116 000 000** lekësh, e shpërndarë në vitet 2019 dhe 2020. Kjo vlerë do të shërbejë, kryesisht, për mbulimin e kostove për:

1. pagesën e personelit të censit;
2. marrjen e zyrave dhe të ambienteve të tjera për magazinimin e pajisjeve e materialeve me qira;
3. mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit/dietave;

4. blerjen e pajisjeve dhe përgatitjen e infrastrukturës IT, ku vlerën më të konsiderueshme e zënë tabletat për marrjen e informacionit.

Pasqyra në vijim paraqet në mënyrë më analitike parashikimet e aktiviteteve dhe vlerat që kërkohet të mbulohen nga buxheti i shtetit.

Kodi i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Total					Total Lekë
		NJËSI	Persona	nr. i njësive	Euro/njësi	TOTAL (Euro)	
A	Kosto e personelit					505 500	67 787 550
A.2	Mbikëqyrës (1 muaj testimi të modelit të përditësimit të hartave)	Month	5	1	300	1 500	201 150
A.3	Mbikëqyrës (100 për 12 muaj, përditësim hartash)	Month	100	14	300	420 000	56 322 000
A.4	Operatorë (20 GIS specialistë zyre për 12 muaj, monitorim dhe kontroll cilësie, 1 specialist për 5 mbikëqyrës)	Month	20	12	350	84 000	11 264 400
C	Trajnime, workshope dhe konsulenca (Total)					13 600	1 823 760
C.4	Kosto trajnimi për aktivitetet e terrenit	Day	68	5	40	13 600	1 823 760
G	Transport/udhetime/akomodime për kontrollorët e terrenit					7 000	938 700
A	Kosto personeli					4 515 000	605 461 500
A.3	Anketues (6000, trajnim 1 jave + 6 jave anketim)	Month	6,000	2	430	4 515 000	605 461 500
F	Hapësira zyre me qira					140 000	18 774 000
G	Transport/udhetime/akomodime					600 000	80 460 000
D	IT hardëare					2 206 750	295 925 108
D.1	Tableta			8,475	250	2,118,750	284,124,308
D.4	Poëer banks + extra cables			8,800	10	88 000	11 800 800
E	Pajisje të tjera materiale dhe të konsumueshme					165 800	22 233 780
E1	Qira për magazinimin e tabletave	Months		24	300	7 200	965 520
E2	Qira për zyrat e stafit IT (61 bashki për 4 muaj)	Months		244	400	97 600	13 088 160
E3	Transporti i tabletave (61 bashki për 2 herë)	Months		122	500	61 000	8 180 100
	Total					8 153 650	1 093 404 398
	TOTAL BUXHETI (pa kostot e rastësishme)					8 153 650	1 093 404 398
							0
10	Kosto të rastësishme					163 073	21 868 088
	2% e shumes totale					163 073	21 868 088
	TOTAL BUXHETI (me kostot e rastësishme)					8 316 722	1 115 272 486

KËSHILLI I MINISTRAVE